




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KTV
Berat Bicaj
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/165 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
KTV (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 5 mars 2021, ka pranuar një ankesë nga Pala ankuese ndaj kronikes” Gradimet dhe emërime të jashtëligjshme nga MPJ-ja edhe gjatë fushatës” të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve të orës 19:00 me datë 25 shkurt 2021 nga Pala përgjegjëse Përmes ankesës Pala Ankuese pretendon se “*kronika televizive për gradimet në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik, e cila përveç tjerash :nuk pasqyron të vërtetën përmban shumë pasaktësi, është tendencioze, nuk bënë dallimin mes lajmit dhe opinionit, nuk u përmbahet vërtetimit të fakteve dhe pasqyrimin të së vërtetës nuk pasqyron raportimin e drejtë dhe të paanshëm, është në vazhden e sulmeve personale dhe nuk respekton të drejtën për reagim dhe korrigjim*”.
3. KPM me datën 8 mars 2021, përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 10 mars 2021, ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse përmes së cilës theksohet se: *Storia e publikuar nga Pala përgjegjëse me titullin “Gradimet në MPJD” është mbështetur në dokumente që vet i ka lëshuar MPJD. Po ashtu, gjatë raportimit kemi pyetur vazhdimisht ministrinë nëse do të ketë rishikim të gradave të cilat janë shpërndarë në mënyrë të pa ligjshme. Përveç kësaj pa ligjshmëritë gjatë qeverisjes së ministres Haradinaj janë konfirmuar edhe nga Zyra e Kryeministrit dhe Presidenca e Kosovës ku katër dekrete i shfuqizoi ushtruesja e detyrës së presidentes. Prandaj, nuk qëndron pretendimi siç thuhet në reagim se nuk kemi bërë dallimin në mes lajmit dhe opinionit ngase në çdo kronikë janë marrë për bazë vetëm faktet dhe dokumente relevante*”.

5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, si dhe ka monitoruar kronikën e lartpërmendur dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 31 mars 2021, ka gjetur se sa i përket pretendimeve për shkelje, për pasaktësi, balancim, njëanshmëri, sulme personale, cenim të të drejtave individuale, Pala përgjegjëse ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës KKPM 2016/03. Ndërsa, sa i përket pretendimit të MPJD-së lidhur me të drejtën e reagimit, Zyra Ekzekutive e KPM-së ka gjetur se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM 2016/03, për shkak të mos transmetimit të reagimit të Palës Ankuese.
6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 23 prill 2021, i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar që në afat prej tre (3) ditëve, t'i ofroni të drejtën e reagimit Palës Ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. KPM, me datën 28 prill 2021, ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse duke cekur se me datën 26 prill 2021, Pala përgjegjëse ka bërë publikimin e pretendimeve të MPJ lidhur me kronikën "Gradimet dhe emërime të jashtëligjshme nga MPJ-ja edhe gjatë fushatës", pavarësisht që jemi përmbajtur standardeve që i promovon Kodi i Etikës KKPM-2016/03.
8. KPM për të vërtetuar se Pala përgjegjëse i ka ofruar të drejtën e reagimit Palës ankuese, ka bërë monitorimin e lajmeve qendrore të datës 26 prill 2021 dhe bazuar në raportin e monitorimi të datës 26 maj 2021, ka gjetur se Pala përgjegjëse nuk e ka transmetuar reagimin e plotë të Palës ankuese, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Analiza Ligjore

9. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 10 paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Nenin 10, paragrafi 1 i Kodit të Etikës KKPM-2016/03 përcakton se:

"Me qëllim të korrektesisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë."


10. KPM, bazuar në Raportin e monitorimit konstaton se Pala përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje, ka vepruar kështu në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, pasi që nuk e ka transmetuar reagimin e plotë të Palës ankuese.
11. KPM-së, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse me mos transmetimin e plotë të reagimit të Palës Ankuese ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 10, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
13. Obligohet Pala përgjegjëse që në afat prej (7) ditësh të transmetojë reagimin e Palës ankues, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

1. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
2. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



29.07.2021
Datë